



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.05/414

Dt. 14.09.2023

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të datës 19.10.2017, Drejtoria e Arsimit, shpall:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: Kuzhinier/e në Institucionet parashkollore

Numri i pozitave: 1 (një)

Orari i punës: 40 orë në javë

Data e njoftimit: 14/09/2023 - 13.10.2023 (<https://konkursi.rks-gov.net>)

Afati për aplikim: 14/10/2023 – 28/10/2023

Detyrat dhe Përgjegjësitë :

- Përkujdeset për përgatitjen e ushqimit në Kuzhinë;
- Përkujdeset për shpërndarjen e ushqimit për fëmijët e institucionit parashkollor;
- Kujdeset që kuzhina dhe të gjitha pajisjet e kuzhinës gjatë përgatitjes dhe shërbimit të ushqimit të përdoren në mënyrë korrekte dhe të jenë në gjendje funksionale dhe të gatshme për përdorim;
- Kujdeset dhe siguron që zonat e gatimit të ushqimit në kuzhinë të jenë në gjendje të pastër: enët e kuzhinës, ushqimi, pemët dhe perimet të lahen mirë;
- Kujdeset që të përdoren metodat e duhura të gatimit të ushqimit, duke siguruar që proteinat dhe vitaminat e ushqimit të mos humbin për shkak të zierjes së gjatë;
- Numërimi i shujtave dhe klasifikimi i tyre në bazë të numrit të fëmijëve;
- Të respektoj orarin e punës dhe hierarkinë/menaxhmentin;
- Bënë porosinë e gjërave të nevojshme ushqimore dhe kujdeset për ruajtjen dhe afatin e përdorimit;
- Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga rregullorja e institucionit apo udhëheqësi i drejtëpërdrejtë.

KUSHTET:

- Përvojë pune në lëmin përkatës;
- Përgatitje profesionale në fushën e kulinarisë;
- Përvojë pune në kuzhina me kapacitet të lartë të përgatitjes;
- Përvojë në përgatitje të produkteve me receta të ndryshme;

Dokumentacodi i nevojshëm për aplikim:

- Formulari i Aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve);
- Diplomën e shkollës së mesme (drejtimi përkatës)
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikata e lindjes;
- Së paku një vit përvojë pune në lëmin përkatës;
- Dëshmitë për përvojën punës në lëmin përkatës;
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht;

- Vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime.

Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në Zyrën për Shërbime me Qytetarë;
- Certifikata e lindjes;
- Dokumenti personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);
- Dëshmi mbi kualifikimin;
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht;
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatet të cilët prahen pas publikimit të rezultateve).

Afati i konkursit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes, pra nga data: 14/10/2023 deri më 28/10/2023 dhe është i publikuar në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në web-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve/>

Mënyra e aplikimit

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në test me shkrim.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave kandidatët do të informohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës, pas mbylljes së konkursit.

Drejtori i DKA-së

Avni Fetahu

